

# Mbi KODIN E PRAKTIKËS në SBS

SBS është një shërbim i pavarur televiziv, radiofonik dhe i medias dixhitale në rang kombëtar. Përgjegjësitë e këtij shërbimi ndaj komunitetit Australian përcaktohen në **Statutin tonë**. Ne financohemi nga qeveria Australiane dhe nëpërmjet mjeteve të tjerë tregtarë si për shembull nëpërmjet reklamave.

Rrjeti ynë sjell histori Australiane, lajme nga vendi dhe bota, të rejtat më të fundit, lajme sportive, seriale dramë, dokumentarë, emisione gatimi, filma dhe emisione radiofonike në më shumë se 60 gjuhë të huaja. Ne jemi burimi kryesor i materialeve rreth Banorëve Autoktone, historive të tyre. E bëjmë këtë nëpërmjet Televizionit Kombëtar Indigjen që transmeton nëpërmjet këndvështrimit Indigjen.

Të gjitha transmetimet tona plotësojnë kërkesat e komunitetit dhe kjo arrihet nëpërmjet Kodit të Praktikës të SBS. Ai përcakton rregullat dhe standardet për të gjitha transmetimet e SBS pavarësisht se ku vijnë ato - në televizion, radio, në internet ose nëpër mediat sociale.



**Kodi i Praktikës mbulon çështje të rëndësishme si....**



## BESIM

**Përmbajtja e transmetimeve tona është e besueshme dhe me vlera**

- Përmbajtja e transmetimeve tona zgjidhet në mënyrë të pavarur.
- Lajmet dhe të rejtat më të fundit janë të sakta, të paanshme dhe në interes të publikut.
- Ne mbështetim një gamë që përfshin të gjitha pikëpamjet dhe këndvështrimet – transmetimet tona janë inovative dhe nxitin sfida, diskutime dhe provokojnë mendime.



## TRANSPARENÇË

**Si ju ndihmojmë të zgjidhni nga transmetimet tona**

- Informacioni vjen tek ju në mënyrë të tillë që ju të jeni në gjendje që të zgjidhni ato materiale që janë të përshtatshme për ju, fëmijët tuaj ose të rinjtë nën kujdesin tuaj.
- Ne sigurohemi që reklamat të tingëllojnë ndryshe nga materialet e tjera dhe zbatojmë rregulla të veçanta në lidhje me transmetimin e disa llojeve të caktuara të reklamave.
- Për atë material që mund të sjellë shqetësime ne marrim parasysh audiencën, ndjeshmëritë, vendosim paralajmërime dhe transmetojmë vetëm ato materiale që janë të miratuara nga redaksia.



## RESPEKT

**Si praktikojmë dhe promovojmë respekt**


- Ne shmangim përmbajtjen që promovon paragjykimet dhe diskriminimet, duke përfshirë përdorimin e pajustificuar të stereotipave në krahasim me përmbajtjen.
- Ne ofrojmë transmetime në gjuhë të huaja dhe inkurajojmë shprehjen e çdo lloj pikëpamjeje.
- Ne jemi të ndjeshëm ndaj mënyrës se si prezantohen çështjet Indigjene dhe respektojmë protokollin kulturor të popullit Aborigjen dhe të Ishujve Torres Strait.
- Ne respektojmë privatësinë e individit, të cilën e barazpeshojmë me përgjegjësitë tona si raportues.



## PËRGJEGJËSI

**Si mbajmë përgjegjësi**

- Ne ju ofrojmë mundësinë për të sjellë mendimin tuaj rreth transmetimeve dhe shërbimeve tona. Ne i mirëpresim si komplimentet ashtu edhe kritikën.
- Ne kemi një proces të pavarur për ankesat i diktuar nga Kodi i Praktikës, dhe ato hetohen nga Avokati i Popullit për SBS.



Mëso më shumë

[sbs.com.au/aboutus/sbs-code-of-practice](https://sbs.com.au/aboutus/sbs-code-of-practice)